DALESE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. / Br. / No. 463-161/1
Date / Datum / Date 19.02.2020

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 18.02.2020
Nr. 0-9/1

**Për:** Frrok Gjergjaj, Udhëheqës i Sektorit Ligjor në Komunën e Gjakovës

**Lënda:** Përgjigje në kërkesën për konsultim paraprak

E nderuara z. Gjergjaj,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar kërkesën Nr. 463-161 për konsultim paraprak lidhur me Propozim-vendimin për caktimin e lokacionit në pronë komunale për ndërtimin e objektit për ushtrimin e aktiviteteve të banorëve të fshatit Skivjanë, Komuna e Gjakovës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, duke u bazuar në vlerësimin e ligjshmërisë sqaron se:

- Kuvendit i Komunës së Gjakovës ka të drejtë të nxjerr vendimin për caktimin e lokacionit, në pronë komunale për ndërtimin e objektit për ushtrimin e aktiviteteve te ndryshme të banorëve të fshatit Skivjanë;

- Vendimi për caktimin e lokacionit, duhet te jetë në harmoni me Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Plani Zhvillimor Komunal, dhe i njëjti nënshtrohet vlerësimit te ligjshmërisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit.

MAPL, është e gatshme të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës .

Me respekt,

**Emilija Redžepi,**
**Ministre e MAPL-së**

______________________

**Kopje:** *Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës*
*Anton Shala, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës*
*Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së*
*Arkivit të MAPL-së*

DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 463-161/1
VI
Data Datum Date 19-02-2020

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Dana, 18.02.2020.
Br. 0-9/1

**Za:** Frrok Gjergjaj, rukovodiolac Pravnog odseka u opštini Đakovica

**Predmet:** Odgovor na zahtev za prethodnu konsultaciju

Uvaženi g. Gjergjaj,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, je primilo vaš zahtev sa br. 463-161 za prethodnu konsultaciju u vezi sa predlogom odluke za određivanje lokacije u vlasništvu opštine za izgradanju objekta za obavljanje aktivnosti stanovnika (meštana) sela Skivjane, Opština Đakovica.

Ministarstvo administracije lokalne samouprtave (MALS) u saglasnosti sa svojim mandatom određenim Zakonom br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi I Uredbom br. 02/2011 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, prilog XII, na osnovu ocenjivanja zakonotosti zahteva tumači da:

- Skupština opštine je donela odluku za određivanje lokalcije u vlasništu opštine za izgradnju objakta za obavljanje raznih aktivnosti meštana sela Skivjane;
- Odluka za određivanje lokacije, treba da bude u skladu sa Zakonom br. 04/L-174 o prostornom planiranju i opštinskim razvojnim planom i ista treba da se podvrgava zakonskom ocenjivanju u Ministarstvu infrastrukture i životne sredine.

S poštovanjem,

**Emilija Redžepi,**
**Ministarka e MALS-a**

**Kopija:** *Adrian Gjini, gradonačelnik opštine Đakovica,*
*Arton Shala, predsedavjući Skupštine opštine Đakovica*
*Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a,*
*Arhivi MALS-a*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

| | |
|---|---|
| Datë/a: | 12.02.2020 |
| Për/ Za/ To: | Rozafa Ukimeraj - Çuni, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| CC: | Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave<br>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Vjosa Ahmetaj, Zyrtare për Monitorim të Komunave<br>Arkivit |
| Përmes/Preko/Through: | Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës |
| Nga/ Od/ From: | Frrok Gjergjaj, Udhëheqës i Sektorit Ligjor |
| Tema/ Subjekat/Subject: | Kërkese për konsultim paraprak |

E nderuar znj. Ukimeraj,

Në mbështetje të nenit 83 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Komuna e Gjakovës kërkon nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, këshill ligjor lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit si vijon:

Komuna e Gjakovës ka pranua disa kërkese për të njëjtën çështje nga përfaqësuesit e banorëve të fshatit Skivjanë, për ndarjen e një parcele përkatësisht parcelën me numër 00775-0, Z.K Skivjanë - Gjakovë, me sipërfaqe prej 1148 $m^2$, për qëllim të ndërtimit të një objekti me vetëfinancim për ushtrimin e aktivitete të ndryshme për banorët të asaj pjese.

Si autoritet mbikëqyrës për shqyrtimin e ligjshmërisë të akteve të Komunave, kërkohet këshilla lidhur me ligjshmërinë e aktit që Komuna e Gjakovës synon të nxjerr dhe atë: Vendim për caktimin e parcelës me numër 00775-0, Z. K Skivjanë – Gjakovë pronë e Komunës së Gjakovës, për qëllim të ndërtimit të një objekti për aktivitetet të ndryshme të banorëve të fshatit Skivjanë.

**Bashkangjitur gjeni:** Draft – Propozim Vendimi.

Me respekt!

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E GJAKOVËS**
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

| | |
|---|---|
| *Data/nr* | **12.02.2020 ____________** |
| *Për:* | **Anton Shala, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës** |
| *CC:* | **- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës**<br>**- Arkivit**<br>**- Sektori Ligjor** |
| *Nga:* | **Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës** |
| *Lënda:* | **Draft Propozim – vendim për caktimin e parcelës 00775-0, Z. K Skivjanë, për ndërtimin e objektit për ushtrimin e aktiviteteve të banorëve të fshatit Skivjanë** |

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41.a dhe h të Statutit të Komunës së Gjakovës, kërkesës me numër 01-016/01-929, datës 14.01.2020, me datën:12.02.2020 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

## P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kryetari i Komunës së Gjakovës i propozon Kuvendit të Komunës së Gjakovës të miraton: vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për ushtrimin e aktiviteteve të ndryshme të banorëve të fshatit Skivjanë.

2. Parcelën me numër 00775-0, Z. K Skivjanë, me sipërfaqe prej 1148 $m^2$ ndahet për ndërtimin e objektit me vetëfinancim të banorëve të fshatit Skivjanë.

3. Qëllim i ndarjen së parcelës është ndërtimi i objektit për ushtrimin e aktiviteteve të ndryshme të banorëve të fshatit sikivjanë, e cila do ju shërbej për interes të përgjithshëm të gjithë banorëve të fshatit.

4. Pjese përbërëse e këtij propozim janë: Certifikata e Pronësisë numër P-70705071-00775-0, Kërkesa për ndarjen e parcelës numër 01-016/01-929, datës 14.01.2020, Draft projekti i objektit.

Me respekt!